



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 645/3 Prot.

Tiranë, më 24 / 05 / 2019

V E N D I M

**Nr. 64 , Datë 24 / 05 / 2019**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 44, datë 10.05.2019, në emër të A.T i përfaqësuar nga Av. A.B dhe Av. K.C kundër Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes politike”, “bindjes filozofike”, “gjendjes shoqërore” dhe “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga A.T, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Në datën 01.04.2019 në mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, është lexuar dhe marrë në shqyrtim relacioni lidhur me punën e Institutit të Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri. Në këtë mbledhje ishin pjesëmarrës vetëm deputetët e grupit të Partisë Socialiste të cilët diskutuan dhe në mënyrë shumë diskriminuese, viktimizuese në prani të mediave vizive kombëtare ka anatemuar jo vetëm institucionin që ankuesi drejton por personalisht drejtuesin e ISKK, A.T, duke i thënë:.....**Instituti me A.T në krye është kthyer në një seksion të Ballit Kombëtar, duke marrë përsipër të nxijë çdo gjë, duke përfshirë, luftën, heronjtë, dëshmorët, etj.....** më pas vazhdojnë: .....**do kërkojmë shkarkimin e A.T derisa ti thërras mendjes, dhe të jetë më i ekuilibruar në veprimet e tij.....** dhe kështu me këtë fjalor kanë vazhduar për gjithë mbledhjen e komisionit të ligjeve. Ankuesi A.T, duke parë që veprimet e parlamentarëve socialistë në mbledhjen e datës 01.04.2019 ishin me tendencë të qarta diskriminuese, viktimizuese nga ato që parashikohen në

nenin 2 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, duke përfitur nga rasti i një takimi që pati me Kryetarin e Kuvendit i shprehu indinjatën e tij lidhur me sjelljen diskriminuese dhe viktimizuese të grupit socialist në komisionin e ligjeve, por Kryeparlamentari, jo që nuk pati mirësinë si njerëzore por as atë institucionale që të merrte masa ndofta edhe disiplinore ndaj parlamentarëve socialistë, duke i kthyer një përgjigje krejt jashtë etike si: ....**Unë nuk jam mësuesi apo kujdestar i tyre....** Gjithashtu, ankuesi A.T duke përfitur nga rasti, shprehu këtë shqetësim edhe kryetarit të grupit parlamentar socialist, por dhe nga ky nuk mori një përgjigje konform etikës parlamentare.... Në këto kushte, ankuesi konstatoi se veprimet e grupit socialist në komisionin e ligjeve, nuk ishin veprime spontane por ishin të mirëorganizuara me qëllim diskriminimin, viktimizimin, etj, të tij. Arsyeja e këtyre sjelljeve diskriminuese të grupit socialist ndaj ankuesit është fakti që ankuesi A.T, ka evidentuar dhe bërë publike emrat e disa personazheve politik ose jo që gjatë periudhës 1944 deri më 1990, me anë të pushtetit politik apo jo, kanë kryer krime ndaj qytetarëve shqipëtarë, ose siç njihen ndryshe “Krime kundër njerëzimit”. Duke qenë se, Partia Socialiste është pasardhëse dhe trashëgimtare e Partisë Komuniste, apo Partisë së Punës dhe disa deputetë kanë qenë pjesë e atij aparati, kanë nxitur dhe krijuar ndaj ankuesit një frymë urrejtje diskriminuese, viktimizuese, etj, ndaj tij”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Për sa më lart, për të vijuar me verifikimin e fakteve të pretenduara nga subjekti ankues, lidhur me diskriminimin e A.T përmes përdorimit të një fjalori diskriminues duke e anatemuar atë dhe institucionin që ai drejton, subjekti ankues i referohet mbledhjes së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të datës 01.04.2019 në të cilin është shqyrtuar dhe miratuar projektrezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së ISKK në Shqipëri për vitin 2018”.

Në diskutimin e mbajtur në mbledhjen e komisionit të datës 01.04.2019, S.B ka folur në emrin e tij si anëtar i komisionit, dhe ka shprehur mendimin e tij për çështjen në shqyrtim.

Nga verifikimi i procesverbalit<sup>1</sup> të mbledhjes së sipërcituar, rezulton se anëtari i komisionit, deputeti S.B, ka deklaruar si më poshtë: *“Nuk jam dakord me përfundimin e relatorit që puna që ky institut ka bërë është e lavdërueshme. Ky institut, me A.T në krye, është kthyer në një seksion të Partisë së Ballit Kombëtar. Ka marrë përsipër të nxijë çdo gjë, duke përfshirë luftën, heronjtë, dëshmorët dhe nuk ka asgjë shkencore në të gjitha analizat që ka bërë. Ky është thjesht një institut studimi që nuk ka pse të ngatërrohet me politikën, nuk ka pse operon me terminologji lustracioni, sepse lustracioni është ndaluar me ligjin që kemi miratuar, në veprimtarinë e të cilit ka shumë helm. Në këto kushte unë nuk do të votoj pro kësaj rezolute, madje do të kërkoj shkarkimin e A.T deri kur ai t'i thërrasë mendjes dhe të jetë më i ekuilibruar në të gjithë veprimtarinë e tij”*. Ndërsa deputeti A.Sh që ishte dhe relatori i projektrezolutës në mes të tjerash, është shprehur si më poshtë: *“..... Do të kërkoja që në variantin përfundimtar të pasqyrohen të gjitha gjetjet e rekomanduara nga V.H, pasi i shoh me vend dhe mendoj se e bëjnë më të plotë draftin përfundimtar të kësaj projektrezolute. Për të gjitha gjetjet individuale të S.B, nuk dua të bëj asnjë koment, por mendoj të mos pasqyrohen në draftin përfundimtar të kësaj rezolute”*.

Subjekti ankues pretendon se S.B me deklaratën e tij të bërë në mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë dhe ndarë në median vizive, e ka vendosur A.T në kushte diskriminuese për shkak të bindjes politike, bindjes filozofike dhe gjendjes shoqërore.

Në analizë të gjithë provave të disponuara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vëren se:

Në nenin 73/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: *“Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes”*.

Në nenin 4/3 të Ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Deputeti ka të drejtë të shprehë lirisht mendimet e tij dhe të zgjedhësve që ai përfaqëson, nëpërmjet diskutimeve, propozimeve, debatit, interpelancave dhe pyetjeve, mocioneve, deklaratave dhe votës”*.

Në nenin 40/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: *“Veprimtaria parlamentare. 1. Deputetët janë në veprimtari parlamentare kur ata marrin pjesë*

<sup>1</sup><http://parlament.al/Files/Procesverbale/20190410150815Komisioni%20i%20Ligjeve%20dat%C3%AB%201.04.2019.pdf>, fq 11.

*në seancë plenare dhe në mbledhjet e komisioneve ose të këshillave; kur marrin pjesë në veprimtari parlamentare brenda ose jashtë vendit; duke njoftuar më parë sekretarinë e Kuvendit, si dhe kur janë në mbledhjet e grupeve parlamentare ose në grupe të ndryshme pune të ngritura nga Kuvendi ose nga komisionet e Kuvendit.....”.*

Referuar legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri vlerëson se deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, gëzon imunitet parlamentar dhe si i tillë deputeti në ushtrimin e mandatit të tij ka të drejtën e lirisë së shprehjes dhe nuk ka përgjegjësi ligjore e nuk mund të ndiqet për shkak të mendimeve të shprehura ose të votës së dhënë prej tij, gjatë ushtrimit të funksioneve parlamentare.

Referuar fjalës në shqyrtim të S.B të mbajtur në Komisionin në Kuvendin e Shqipërisë në datë 01.04.2019 është e qartë që nuk përmban shprehje që synojnë të nxisin urrejtje<sup>2</sup> apo veprime të dhunshme ndaj subjektit ankues, përkundrazi ato janë shprehje e vlerësimit të një deputeti të caktuar, si pjesë e Komisionit përgjegjës, kundrejt veprimtarisë vjetore të një institucioni që Kuvendi ka detyrën që ta kontrollojë.

Referuar vendimit të GJEDNJ-së në çështjen Handyside v. Mbretërisë së Bashkuar<sup>3</sup>, Gjykata bën një dallim mes një nxitjeje serioze për ekstremizëm dhe të drejtës së individëve për të shprehur këndvështrimin në mënyrë të lirë. Ashtu siç është shprehur Gjykata: *“..në funksionet e veta mbikëqyrëse e detyrojnë atë t’i kushtojë vëmendje të madhe, parimeve që karakterizojnë një “shoqëri demokratike”. Liria e shprehjes përbën një nga themelet bazë të një shoqërie të tillë, një nga kushtet bazë për progresin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu”<sup>4</sup>.*

GJEDNJ ka përcaktuar parametrat që do të bënin të mundur të karakterizonin “gjuhën e urrejtjes” në mënyrë që ta përjashtonin nga mbrojtja e saj përmes lirisë së shprehjes. Në çështjen Faruk Temel v. Turqisë, GJEDNJ ka theksuar në veçanti që subjekti ka folur si përfaqësues politik dhe anëtar i parlamentit, dhe ka prezantuar qëndrimet politike të partisë së tij në çështje të veçanta me interes të përgjithshëm. Në këtë vendim GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se fjala e tij, marrë në përgjithësi, nuk kishte nxitur të tjerët në përdorimin e dhunës, rezistencës së armatosur dhe nuk ka arritur deri tek gjuha e urrejtjes<sup>5</sup>.

Në çështjen Castells v. Spanjës 1992, GJEDNJ në hetimin e kushtit se ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, është shprehur: *“Ndërsa liria e shprehjes është e rëndësishme për këdo, është veçanërisht e tillë për një përfaqësues të zgjedhur nga populli. Ai përfaqëson elektoratin e tij, tërheq vëmendjen për preokupimet e tyre dhe mbron interesat e tyre. Liria e shtypit i jep publikut një nga mjetet më të mira për të zbuluar dhe krijuar një mendim mbi idetë dhe qëndrimet e drejtuesve politikë. Në veçanti, kjo liri i jep politikanëve mundësinë për të reflektuar dhe komentuar mbi preokupimet e mendimit publik; kështu, mundëson cilindo që të*

<sup>2</sup> Mbështetur në Rekomandimin 97 (20) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, miratuar në 30.10.1997, “fjalimet e urrejtjes”, përfshijnë të gjitha format e shprehjes të cilat shpërndajnë, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes bazuar në mungesën e tolerancës.

<sup>3</sup> Handyside v. United Kingdom (application no. 5493/72, datë 07.12.1976).

<sup>4</sup> Handyside v. United Kingdom (application no. 5493/72, datë 07.12.1976), paragrafi 49, përkthim i Komisionerit.

<sup>5</sup> Faruk Temel v. Turkey (application no. 16853/05, datë 01.02.2011). ECHR, Factsheet – Hate speech, page 6.

*marrë pjesë në debatin e lirë politik, i cili qëndron në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike<sup>6</sup>”.*

Referuar fjalës në shqyrtim, mund të themi se S.B e ka shprehur opinionin e tij në lidhje me vlerësimin e veprimtarisë së institucionit për të cilin po diskutohej në komision dhe ka shprehur qëndrimin e tij, duke bërë argumentim të arsyes për mosvotimin pro të rezolutës. Në vlerësim të Komisionerit, synimi i S.B nuk ka qenë diskriminimi dhe përhapja e urrejtjes ndaj institucionit dhe A.T por ka shprehur qëndrimin dhe bindjet e tija kur është shprehur se: “..... *Ka marrë përsipër të nxijë çdo gjë, duke përfshirë luftën, heronjtë, dëshmorët dhe nuk ka asgjë shkencore në të gjitha analizat që ka bërë. Ky është thjesht një institut studimi që nuk ka pse të ngatërrohet me politikën, nuk ka pse operon me terminologji lustracioni.....*”.

**Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se fjala e S.B e mbajtur në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë në datë 01.04.2019, gjuha e përdorur dhe qëllimi i saj nuk ka qenë që të nxisë urrejtje apo qëndrim diskriminues dhe shprehjet e përdorura nuk janë të atij niveli që të nxisin qëndrime diskriminuese apo veprime të dhunshme ndaj A.T dhe Institutit të Studimeve për Krimet dhe pasojat e Komunizmit në Shqipëri.**

Lidhur me pretendimin e A.T kundër Kryetarit të Kuvendit, për përgjigjen e dhënë gjatë zhvillimit të punimeve të datës 12.04.2019 “Takimi i parë vjetor i Kryetarit të Kuvendit me institucionet e pavarura”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se shprehja e Kryetarit të Kuvendit: “...*unë nuk jam mësuesi apo kujdestari i tyre....*”, dhe qëndrimi i mbajtur, nuk është i atij niveli që të ketë vënë në pozita të pafavorshme subjektin ankues.

Në lidhje me Deputetin dhe njëkohësisht Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, ankuesi nuk ka cituar ndonjë shprehje konkrete, prandaj dhe Komisioneri nuk mund të shprehet.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse: është haptazi e pabazuar.....*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 33, pika 4/ç, neni 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

---

<sup>6</sup> Udhëzues për implementimin e nenit 10 të KEDNJ, M.Macovei, faqe 42-43.

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës për shkak se është haptazi e pabazuar në dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONER**